

INSTITUTI I KURRIKULËS DHE STANDARDEVE

PROGRAMI MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT

LËNDA:GJUHË ITALIANE

(klasa e nëntë)

Tiranë, 2008

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

- I. HYRJE
- II. SYNIMET
- III. OBJEKTIVAT
 - PËRSHKRIMI I AFTËSIVE GJUHËSORE
 - AKTET / FUNKSIONET KOMUNIKATIVE
 - TEMATIKA
 - STRUKTURAT GRAMATIKORE
- IV. SHPËRNDARJA E ORËVE
- V. INTEGRIMI
- VI. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT
- VII. VLERËSIMI DHE VETËVLËRËSIMI
- VIII. SHTOJCË:
MODEL ORIENTUES I LIDHJES SË TEMËS, AFTËSIVE, AKTEVE
KOMUNIKATIVE, ELEMENTEVE GRAMATIKORE E LEKSIKORE

I. HYRJE

Në përgatitjen e këtij programi, autorët u janë referuar dhe i janë përmbajtur strukturës, niveleve dhe përcaktimeve të vizionit kurrikular e të kurrikulës kombëtare të gjuhëve moderne (MASH, 1999), si dhe kuadrit të përbashkët të referencave të Këshillit të Evropës (Strasburg, 1998).

Për nxënësit e klasës së nëntë, të familiarizuar tashmë me gjuhën, të flasësh për ndërgjegjësim në përvehtësimin e gjuhës dhe për rëndësinë e studimit të saj është disi më e thjeshtë pasi gjatë viteve pararendëse të studimit të gjuhës së huaj ata janë njohur me shumë prej veçantive social kulturore e gjuhësore të vendit gjuhën e të cilit studiojnë prej vitesh. Gjithsesi mbeten gjithnjë të hapura e domosdoshmërisht të trajtueshme, në këtë stad, në një shkallë më të lartë të përvehtësimit të njohurive, tematica, funksione apo struktura gramatikore në përputhje me objektivat dhe synimet që vendosim për klasën e nëntë duke u siguruar sërish nxënësve autonomi në përdorimin e gjuhtës përmes mjeteve të përshtatshme për një komunikim imediat.

Ky program nënkupton drejtimin, mbështetjen dhe nxitjen e nxënësit në nevojën për t'u përshtatur, për t'u shprehur, për të komunikuar në mjedise shkollore dhe jashtëshkollore në gjuhën italiane.

Gjithnjë në kuadër të ndryshimeve të sistemit shkollor (shtrirja e arsimit të detyruar 9-vjeçar), plani mësimor i gjuhës italiane në klasën nëntë pëmban 3 orë javore.

Duke pasur parasysh moshën e nxënësit, në program është bërë përshtatja e kësaj grupmoshe me tematikën, objektivat, aktet dhe funksionet komunikuese.

Programi i klasës së nëntë mbështetet në njohuritë dhe aftësitë e përfituara nga nxënësit në klasat paraardhëse, duke i zgjeruar dhe duke i thelluar ato. Synimet dhe objektivat didaktikë, të paraqitura në këtë program, janë mbështetur dhe ngrihen mbi nivelin e njohurive të programeve të klasave III – VIII, duke i riparë dhe ridimensionuar ato.

II. SYNIMET

Ashtu siç është sqaruar edhe në kuadrin e përgjithshëm të kurrikulës, mësimdhënia / mësimnxënia e gjuhës së huaj, pra edhe e gjuhës italiane bazohet dhe mban parasysht parimet, synimet dhe objektivat që ka përcaktuar shkolla jonë. Ato u përgjigjen:

-zhvillimit të dialogut ndërkulturor

-zhvillimit të një kulture demokratike,

-nevojave dhe interesave individuale të nxënësve,

-sjelljen në klasë të përvojës bashkëkohore në arsim,

Për të përmirësuar në vazhdimësi procesin mësimor në këtë hallkë të sistemit shkollor, janë mbajtur parasysht:

ruajtja e atyre pjesëve të përshtatshme të kurrikulës ekzistuese dhe integrimi i tyre me elemente të reja ku të jetë e nevojshme;

liria dhe pavarësia e mësuesit,

nxitja dhe përdorimi i metodave e materialeve mësimore që mbështetin krijimtarinë dhe pavarësinë mendore të nxënësit,

forcimi i pozitës që nxënësi ka si qendër e procesit mësimor,

nxitja e përdorimit dhe e studimit të materialeve autentike, me burim nga masmedia e shkruar dhe e folur,

ndërgjegjësimi i nxënësit për identitetin e vet kulturor, nxitja dhe motivimi i tij për ta krahasuar atë me kulturën e vendit fqinj.

Synimet didaktike për klasën e nëntë mbeten pothuajse të njëjtat e klasave pararendëse pasi e tërë shtrirja kurrikulare është konceptuar duke pasur në themel edukimin e nxënësve me ato tipare e shprehi që synojnë një qytetar të aftë të orientohet dhe të japë maksimumin në një kontekst globalizimi ndërkulturor. Për këtë themi se disa prej synimeve mbeten:

-nxitja e zhvillimit konjitiv të nxënësit përmes një mjeti të ri organizimi e transmetimi njohurish (zhvillimi i individualitetit të nxënësit; zhvillimi i të nxënësve të pavarur, zhvillimi i mendimit kritik etj.);

-krijimi i mundësive, përmes kodit gjuhësor, që nxënësi të njohë e të kuptojë kulturën e vendit tjetër (zhvillimi i ndërgjegjësimit për identitetin kulturor; zhvillimi i tolerancës dhe i respektit për diversitetin mes njerëzve e kulturave etj.).

III. OBJEKTIVAT

Për secilën aftësi përcaktohen objektivat e të nxënësve. Këto aftësi janë të konceptuara brenda linjave e nënlinjave të mëposhtme dhe janë përcaktuar në mbështetje të Udhëzimit të Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës Nr.49, dt.27.12.2006 “Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve”.

Për secilën aftësi përcaktohen objektivat e të nxënësve. Këto aftësi janë të konceptuara brenda linjave dhe nënlinjave të mëposhtme:

Linja	Nënlinja
1.Komunikimi dhe formimi kulturor	a.Kultura dhe komunikimi
	b.Aktet dhe funksionet e komunikimit
2.Formimi gjuhësor	a.Elementet/strukturat gramatikore
	b.Tematika

Duke iu referuar kuadrit të përgjithshëm të Kurrikulës së Gjuhëve Moderne, performanca e përgjithshme e nxënësve të klasës së tetë filllore do të përshkruhet sipas standardeve të mëposhtme, të përshkruara sipas aftësive të veçanta:

Objektiva didaktike të përgjithshme: Përdorimi i metodës komunikative mbetet sërisht në bazë të objektivave didaktike që synojnë një zhvillim, deri diku i baraspeshuar, i të katër aftësive bazë (të kuptuarit dhe të shprehurit me gojë, të kuptuarit e të shprehurit me shkrim)..

Aftësi gjuhësore nënkupton njohjen pasive dhe aktive (të kuptuarit dhe të shprehurit) të strukturave gjuhësore bazë, në aspektin e tyre:

- fonetik,
- morfologjik,
- sintaksor,
- leksikor,
- funksional.

Përmes njohjes së strukturës, të leksikut dhe funksioneve, nxënësi, gjatë studimit të gjuhës italiane do të njohë edhe kulturën dhe qynëntërimin që ajo gjuhë bart. Kjo do të bëjë të mundur edhe ballafaqimin me kulturën dhe qynëntërimin e vet kombëtar.

Vëmendja e përqendruar për gjuhën e folur kërkon veprimtari të përqendruara mbi përdorimin praktik të strukturave dhe elementeve komunikuese. Vërejtjet gramatikore do të duhet të bëhen vetëm në vijim të këtij procesi dhe për të forcuar nxënien e strukturave në fjalë. Gramatika të konceptohet përgjithësisht në mënyrë deduktive që të nxitet nxënësi drejt një procesi analitik dhe mendimi kritik. Vetëm përmes tekstesh leximi, kryesisht autentike, të bëhet paraqitja dhe futja e strukturave dhe/ose e rregullave gramatikore dhe jo si një proces shpjegimi statik tabelash apo rregullash.

Aftësi komunikuese nënkupton të përdorurit në mënyrë të pavarur të kodit gjuhësor, në mënyrë korrekte dhe të përshtatshme me situatat komunikuese të dhëna, situata që lidhen me kontekstin e përgjithshëm e të përditshëm të jetës së nxënësve. Në këtë kuadër trajtohen edhe elemente të natyrës jashtëgjuhësore (gjestet, mimika, prosemika etj.), të

cilat mësuesi, në varësi të rrethanave konkrete në procesin mësimor, i përdor dhe ua shpjegon edhe nxënësve kuptimin dhe përdorimin.

Aftësia komunikuese do të zhvillohet përmes ushtrimit të katër aftësive gjuhësore bazë, të cilat integrohen njëra me tjetrën në masë të baraspeshuar atje ku është e mundshme dhe e përshtatshme. Aftësitë gjuhësore janë:

- (a) të kuptuarit me gojë (dëgjimi dhe reagimi),
- (b) të kuptuarit me shkrim (leximi),
- (c) të shprehurit me gojë (të folurit),
- (d) të shprehurit me shkrim (të shkruarit).

Objektivi socialkulturor: Strukturat gramatikore e leksikore përvetësohen më mirë të vendosura në kontekst përdorimi më të gjerë. Integrimi i elementeve të qynëntërimit në mësimin e gjuhës së huaj shton motivimin e nxënësve, duke i çuar ata në një realitet tjetër të ndryshëm nga ai ku jeton. Ai ngjall interesim, kërshtëri për vendin gjuhën e të cilit është duke mësuar, për zakone, rite, norma të ndryshme nga të tjerët. Ai zgjeron njohuritë dhe kulturën e tij të përgjithshme.

1.Përshkrimi i aftësive gjuhësore (performanca gjuhësore)

Të dëgjuarit

Në përfundim të klasës së nëntë, nxënësi:

- ndjek biseda të përditshme të artikuluara qartë dhe me përsëritje të fjalëve dhe shprehjeve të veçanta për atë të vështira;
- kupton një bisedë relativisht të gjatë rreth tij, familjes së tij, shkollës, aktiviteteve kulturore etj., kur gjuha e përdorur është e thjeshtë dhe standarde;
- ngre hipoteza mbi përfundimin e një ndodhie të dëgjuar në magnetofon apo të lexuar;
- kupton materiale të thjeshta të regjistruara, ose lajme televizive kur këto janë të shoqëruara me veprime e figura;
- kupton të dhëna të thjeshta teknike për instrumente që ai i njeh: kompjuter, makinë llogaritëse, televizor, magnetofon, cd etj.

Të folurit

Në përfundim të klasës së nëntë, nxënësi:

- fillon, vazhdon dhe përfundon një bisedë për një temë shumë të njohur ose që paraqet interes;
- merr pjesë në një bisedë apo diskutim, duke kuptuar plotësisht çka i thuhet nga bashkëfolësi moshatar dhe shpreh me lirshmëri atë që dëshiron të thotë mbi tema të njohura të jetës së përditshme;
- shpreh ndjenja të tilla si: habia, gëzimi, trishtimi, kureshtja, indiferenca dhe reagon ndaj të njëjtave ndjenja të shprehura nga të tjerët;
- shkëmben pikëpamje apo shprehin mendime vetjake në një diskutim ndërmjet miqsh e të njohurish;
- shpreh me mirësjellje nëse e pranon diçka apo jo;
- flet në mënyrë të kuptueshme dhe pa shumë hezitim, duke bërë pauza për të planifikuar ose për të qortuar atë që thonë;

- tregon përmbajtjen e një libri të thjeshtë apo të një filmi dhe përshkruan reagimet e tij;
- shpreh në mënyrë të thjeshtë pasazhe të shkurtra të një teksti të shkruar, duke përdorur fjalët dhe renditjen e tekstit origjinal;
- transmeton një informacion të thjeshtë me interes të domosdoshëm;
- zotëron një fjalor të mjaftueshëm për t'u shprehur në jetën e përditshme.

Të lexuarit

Në përfundim të klasës së nëntë, nxënësi:

- kupton çka lexon në artikuj gazetash apo revistash rreth temash të aktualitetit dhe të interesit të tij të moshës;
- kupton informacionin që jep një manual përdorimi sendesh shtëpiake;
- kupton informacionin që gjendet në tekste letrare të një vështirësie mesatare;
- kupton instruksione, manuale të thjeshta në përdorimin e pajisjeve elektro-shtëpiake;
- kupton ndodhitë e personazheve që gjenden në librat e tij të leximit apo ato jashtë klase;
- kupton informacionin që lidhet me vendndodhjen apo kohën në të cilën është kryer veprimi (kush, ku, kur);
- kupton nga konteksti fraza apo fjalë të veçanta ende të pastudiuara prej tij;
- kupton mjaftueshëm tekste të panjohura prej tij por që lidhen gjithnjë me fusha të interesit të tij dhe me tema të njohura prej tij;
- kupton tekste të ndryshme të shprehura në një gjuhë të thjeshtë të përdorimit të përditshëm.

Të shkruarit

Në përfundim të klasës së nëntë, nxënësi:

- shkruan një letër apo kartolinë bashkëmohatarëve, duke shprehur ndjenjat e tij;
- formulon një e-mail të shkurtër, apo sms, në një gjuhë sa më të thjeshtë;
- i përgjigjet një lajmërimi në gazetë apo kërkon informacion më të plotë për tema të interesit të tij;
- shkruan tekste të thjeshta për tema të ndryshme;

2. Aktet / funksionet komunikuese

Për t'u ardhur sa më mirë në ndihmë mësuesve aktet apo funksionet e komunikimit po i shprehim në gjuhë të huaj. Këto akte e funksione parashikohet të shprehen përmes teksteve të përzgjedhura me kujdes nga mësuesi e të realizohen përmes një sërë aktiviteteve ludike në mënyrë që automatizimi i tyre të kryhet sa më lehtësisht e të jetë sa më i qëndrueshëm.

Disa prej funksioneve dhe leksiku mbështetës paraqiten si më poshtë:

ATTI COMUNICATIVO		AREE LESSICALI
Tecniche della comunicazione	chiedere il permesso di parlare	Permesso / Permette una parola
	dare la parola a chi l'ha chiesta	Prego / Dica (pure)
	portare esempi	Per esempio
	riempitivi del discorso	Vero? / Non è vero? / No?
	tradurre	A vuol dire B / A significa B / A si dice B / Come si dice A in italiano? / Come si traduce A in italiano? / Cosa vuol dire A in italiano? / Cosa significa A in italiano?
Sentimenti	indifferenza	Importare: Non m'importa affatto. / E allora? / Per me è lo stesso! / fregarsene

neutri	perplexità	Cosa faccio? / Non so che fare!
	rassegnazione	Pazienza! / Non importa! / Fa lo stesso! / Non c'è niente da fare
	sorpresa	Davvero? / (è) impossibile! / (è) incredibile! / Scherzi?! / Non ci credo! / No?!
Senti menti negati vi	antipatia	Non mi va: quel ragazzo non mi va. / Antipatico / Non poter vedere: Non lo posso vedere
	disapprovazione, disaccordo	Hai fatto male! / Non essere d'accordo: Non sono d'accordo che tu ci vada. / Non sono d'accordo con te. / Essere contrario: sono contrario ad invitarlo. / Sono contrario alla tua partenza.
	lamentarsi	Povero me! / Ma perché? / Dio mio! / Mamma mia!
	noia	Noioso / Che barba! / Uffa! / Basta!
	insoddisfazione	Così non va! / insoddisfatto
	disinganno, delusione, rimpianto	Peccato! / Come mi dispiace!
	Dispiacere, infelicità, tristezza, disperazione	Piangere Triste / Che tristezza! / Infelice / Purtroppo! Purtroppo il treno è in ritardo / Disperato: è disperato perché ha perso il passaporto.
	Odio, disgusto	Odiare / Fare schifo: gente così fa schifo / Che schifo!
	Sfiducia, diffidenza	non fidarsi: non mi fido più di lui.
	Irritazione, rabbia	Che nervi! / Va al diavolo! / Accidenti! / Porca miseria! / Seccato: sono seccato per il tuo ritardo. / Furioso: sono furioso per lo sciopero dei treni.
	ansia	Speriamo che: speriamo che venga!
	Timore, paura	Avere paura: ho paura che la macchina sia rotta / ho paura di non farcela / ho paura dei topi
Cattivo umore	Essere giù: sono molto giù in questo periodo. / Depresso: sono molto depresso. / Che nervi! / Va al diavolo! / Accidenti! / Porca miseria! / Seccato: sono seccato per il tuo ritardo. / Furioso: sono furioso per lo sciopero dei treni.	
Progetti d'azione		
Azioni che concernono noi stessi	Offrire di fare noi stessi	Posso, potrei: posso accompagnarti / Indicativo+(volentieri)+(se vuoi): Ti accompagno (volentieri, se vuoi) / Vuoi che: Vuoi che ti accompagni?
	Promettere di fare noi stessi	Promettere: ti prometto di accompagnarti / Promesso! / Assicurare: ti assicuro che lo farò / Ti assicuro di aiutarti
	Intenzione, volontà, decisione di fare	Penso di / Futuro: me ne andrò di qui / Presente indicativo: domani me ne vado / Volere +infinito: Vorrei partire domani / Decidere di +infinito: ho deciso di andarmene.
	rinuncia	Decidere di non +infinito / Penso che non: penso che non me ne andrò.
	Voglia, desiderio di fare	Ho voglia di +infinito: ho voglia di fare una passeggiata. / Andare (di+infinito): Ti va un caffè? / Ti va di partire? / Condizionale (+volentieri): Berrei volentieri un caffè.
	Avversione a fare	Non aver voglia di +infinito / Non mi va di +infinito
	Fare domande su propositi di azione proprie: Chiedere consiglio Domandare il permesso Domandare il permesso di non fare	Dammi un consiglio / Dimmi che cosa pensi Vorrei sapere che cosa ne pensi / Vorrei la tua opinione / Cosa faccio? / Cosa devo fare? / -Potere +infinito: posso prendere un foglio di carta? / Si può +infinito: Si può fumare? -devo (proprio) +infinito / preferirei (di) non +infinito
Azioni che concernono	Proporre di fare insieme	Potere+ infinito: Possiamo/potremmo andare al cinema. / Volere+infinito:Vorresti/vuoi andare a teatro? / Frase interrogativa: Andiamo al cinema? / Frase interrogativa: Vieni a cena domani? / Perché non +verbo: Perché non vieni al cinema? /

noi ed altri insieme		Imperativo: Domani vieni a cena da noi.
Azioni che conce- rnono solo gli altri	Suggerire, consigliare che gli altri facciano	Potere+infinito: Potresti parlargli. Perché non +indicativo: Perché non gli aprli? Perché non +infinito: Perché non parlargli?
	Avvertire, segnalare, mettere in guardia	Attenzione che: attenzione che c'è sciopero. / Stare attento a: stai attento al traffico. / Stai attento a non cadere. / Vedi/guardi di (non): Vedi/guarda di non fare tardi.
	Permettere ad altri di fare	Imperativo+pure: Parla pure / Potere+(pure) +infinito: Puoi (pure) prendere la mia macchina.
	Dispensare se vuoi	Imperativo negativo (+se vuoi): Non andare se vuoi. Potere+infinito negativo (+se vuoi): Puoi non andare, se vuoi.
	Invitare a fare, incoraggiare	Prego / Imperativo (+pure): Fai pure / Serviti
	Chiedere, ordinare	(per favore) può +infinito: Per favore può chiudere la porta?
	Pregare di fare	Ti prego +imperativo: ti prego, vieni! Ti prego di +infinito: ti prego di venire.
	Chiedere di non fare	Ti dispiace di non +infinito: Ti dispiace di non fare chiasso? Smettere: smettila di seccarmi Piantala: piantala di fare chiasso.
Comunicazioni		
Scambi di comunicazio- ne su dati di fatto	asserire che si è verificato qualcosa	Frase affermativa: E' inverno. / Maria è partita. / Certo che Maria è partita.
	Riportare, raccontare	Frase dichiarativa Termini linguistici come: dire (ha detto), dichiarare (ha dichiarato), raccontare, narrare
	descrivere	Localizzazione spazio-temporale / Qualificazione
	paragonare	Paragone di quantità / Paragone di qualità / Comparativo assoluto e relativo / Simile / Lo stesso di somigliare
	annunciare, informare di un fatto	Sapere: (non) sapete che è cambiato l'orario? Frase affermativa (+sapete): E' tardi, (sapete)?!
	Chiedere informazioni su dei fatti	Frase interrogativa diretta / Frase interrogativa indiretta / Non so se / Sai se? / Chi? / Quando? / Perché? / Dove? / Come? / Quanto? / Ecc.
Esprimere che qualcuno ha/non ha la capacità di compiere un'azione	Sapere: So sciare, so nuotare / Essere capace di	
Esprimere ed indagare sulla conoscenza di un fatto	sapere	So (bene, perfettamente) che / Sono sicuro (certo) che
	non sapere	Non so se / Non sono sicuro che/se / Chissà (se)
	credere	Penso che / Credo che / Mi pare che / Mi sembra che
	chiedere opinioni o giudizi	Sapere: sai se...? / Credere: credi che...? / Dimmi cosa ne pensi / Vorrei sapere cosa ne pensi / Vorrei la tua opinione
	dubbio	Non so se / Non sono sicuro se
	ricordare	Ricordare: Mi ricordo che era notte / Mi ricordo di lui benissimo / Dimenticare: non mi dimentico che... / Non mi dimentico di te.
	dimenticare	Dimenticare/dimenticarsi che/di: / non dimenticarti di telefonare. / Non dimenticarti che piove.

3. Sferat tematika dhe leksiku

Përmbajtja tematike e programit të klasës IX është rimarrje e asaj që është trajtuar në ciklin e mëparshëm (klasat III-VIII), por në formë më të pasuruar e më të thelluar në planin leksikor, gramatikor, komunikues.

Në tërësi, mbeten të njëjta sferat tematike, ashtu si në nivelin parardhës. Sipas parimit spiral (rimarrja në mënyrë më të zgjeruar), ritrajtohen në një nivel më të lartë e më të gjerë temat e mëposhtme të grupuara në 7 fusha apo sfera, sipas konceptimit të kurrikulës kombëtare, vizionit kurrikular dhe kuadrit të referencave të Këshillit të Evropës:

a.Sferat tematike

Rimerren pjesa më e madhe e temave dhe çështjeve të trajtuara në pesë nivelet pararendëse (klasa III-VIII) që lidhen me interesat dhe nevojat e kësaj moshe, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e përmbajtjes, por në formë më të zgjeruar.

a.Veprimtaria e përditshme:

Tregu, shpenzimet në treg, rrugë a në supermarketë;
Familja, të afërmit, marrëdhëniet familjare, ndarja e detyrave në familje;
Kafshët shtëpiake; llojet e tyre;
Festat familjare; organizimi i festës, tavolina, dhurata, ëmbëlsira; veshja sipas stinës e dhe rasteve speciale, tregjet;
Shokët dhe shoqet e lagjes; marrëdhënia me to;
Koha e lirë dhe hobet; lojërat, pasionet, librat etj.;
Ditët, muajt, datat, orët;
Shtëpia, mjediset e brendshme, objektet apo sendet në të, llojet e banesave; efektet e teknologjisë në rutinën e një shtëpie;
Guzhina, ushqime dhe pije (ndonjë veçori e kuzhinës shqiptare dhe italiane).

b.Jeta personale dhe shoqërore:

Shëndeti, sëmundjet, tipat e sëmundjeve të përgjithshme, trupi, higjiena; njohja me rregullat e higjienës;
Mënyra e të veshurit, prirjet; moda;
Karakteristika të shokëve dhe të popullit italian;
Popujt dhe pamja e tyre e jashtme (momente ndërkulturore); miqësi të reja; në plazh; në chat, me e-mail etj.

c.Bota rreth nesh, mjedisi fizik në vend dhe në botë:

Qyteti, shtetet, kontinentet;
Koha, moti, stinët, klima;
Adresa, mjetet e transportit e të telekomunikacionit; TV, radio, SMS, cel., e-mail;
Udhëtimet e bëra apo që dëshirohet të bëhen; trafiku;
Vende takimi dhe argëtimi, monumente arti e historike;
Monedhat, dyqanet, tregu; mjedisi, natyra e vendit, industria, bujqësia;
Zyrat publike; bashkia (komuna) dhe personeli, gjendja civile.

ç.Bota e arsimit, trajnimit dhe punës:

Shkolla, klasa, objektet përreth, orari; mësuesit, drejtuesit, marrëdhëniet me ta, përshkrimi i personalitetit;
Shokët dhe shoqet e grupit, marrëdhëniet me ta;
Personeli i shkollës; marrëdhëniet me ta;
Një ditë në shkollë;
Lënda mësimore dhe preferencat lëndore; lënda e re dhe mendime për lëndën;
Përcaktimi i veprimtarive (lexim, shkrim);
Librat dhe biblioteka, llojet e gjinive: aventuresk, shkencor; numrat dhe veprimet aritmetike; formimi i klubeve, grupeve etj.;

d.Bota e komunikimit dhe teknologjisë, komunikimi në largësi të madhe dhe përdorimet e teknologjisë:

Programe radio-televizive të ndjekura; herojtë dhe personazhet e filmave të ndjekur nga ky grup-moshë;

Korrespondenca elektronike me miqtë; kompiuteri, SMS etj;

dh.Bota e imagjinatës dhe krijimtarisë veprimtaritë artistike dhe krijuese:

Lojërat, sporti, garat; llojet e lojërave, lojërat kompiuterike, veshjet e pajisjet sportive;

Kultura popullore, muzika, veprimtaritë në kohën e lirë.

e.Tregime, përshkrime vendesh e ngjarjesh.

b.Leksiku

Nga sa pamë kur trajtuam sferën e leksikut së bashku me funksionet, duket qatrë se përzgjedhja e teksteve bazohet mbi një repertor leksikor, pjesa më e madhe e të cilave i përkasin fjalorit bazë të gjuhës italiane, ndërsa pjesa tjetër lidhet me fusha dhe kontekste përdorimi të veçanta për grup-moshën.

4. Elemente dhe struktura gramatikore

a.Morfosintaksa

Strukturat e parashikuara synojnë të nxisin aftësinë komunikuese të nxënësve duke aktivizuar funksionet minimale. Këto janë strukturat më të përdorshme që bëjnë të mundshme realizimin e komunikimit në një nivel minimal brenda fushës tematike të përzgjedhur;

Niveli i nxënësve paramendon zotërimin e këtyre strukturave morfo-sintaksore:

-mbiemri cilësor dhe përcaktor;

-rimerret zgjedhimi i foljeve të çrregullta në mënyrat dhe kohët e mëposhtme, format vetvetore e përemrore:

-dëftore (presente, passato prossimo, imperfetto, futuro anteriore, trapassato prossimo)

-urdhërore, urdhërore me trajtat përemrore

-përcjellore (stare + përcjellore).

-forma e mirësjelljes me kushtore.

-mbiemri dhe përemri i pacaktuar;

-lidhëzat;

-parafjalët e thjeshta dhe të përbëra;

-fjalë e thjeshtë në katër llojet themelore (dëftore, pyetëse, habitore, urdhërore);

-fjalë me bashkërenditje e nënrenditje;

-foljet kalimtare dhe jokalmimtare;

-forma pasive, aktive e foljeve;

-foljet modale + paskajore.

b.Fonetika

Synohet sërish aftësimi i nxënësit për një shqiptim korrekt të fjalëve dhe fjalive me intonacionin dhe muzikalitetin e duhur.

IV. SHPËRNDARJA E ORËVE (Struktura sintetike e programit)

35 javë x 3 orë = 105 orë

Paraqitje njohurish të reja, veprimtari ushtruese, përforcuese, rimarrëse:	87 orë
Veprimtari përsëritëse / rikapitulluese:	4 orë
Veprimtari verifikuese / kontrolluese të njohurive dhe të aftësive:	4 orë
Veprimtari të ndryshme të lira:	10 orë
<i>Gjithsej:</i>	105 orë

Paraqitje njohurish të reja, veprimtari ushtruese, përforcuese, rimarrëse (87 orë). Në kuadrin e garantimit të autonomisë së mësuesit në mësimdhënie, ky është i lirë që të planifikojë vetë mësimin, numrin e orëve që nevojiten për secilën njësi didaktike në varësi të nivelit të nxënësve me të cilët punon.

Veprimtari përsëritëse / rikapitulluese (4 orë). Gjatë përsëritjes së njohurive të fituara deri në atë pikë, të synohet rifreskimi i njohurive, funksioneve, nocioneve e strukturave më të rëndësishme si dhe përdorimi i tyre në situata të tjera.

Veprimtari verifikuese / kontrolluese të njohurive dhe të aftësive: (4 orë). Me këtë veprimtari, me shkrim, nuk synohet vetëm vlerësimi i thjeshtë i njohurive, por edhe njëfarë ndërjegjësimi paraprak i nxënësit për rezultatin e punës dhe të arritjeve individuale, çka do t'i shërbente motivimit të për të vazhduar procesin e të nxënësve gjuhësor.

Veprimtari të ndryshme të lira (10 orë). Kjo sasi orësh i lihet në dispozicion nismës dhe planeve që mësuesi dhe shkolla kanë në funksione të përmbushjes dhe realizimit sa më të mirë të nevojave dhe interesave të nxënësve dhe të komunitetit, në përputhje me këtë program dhe me Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës Nr. 38, dt. 9.10.2007 për orët e lira.

Veprimtaritë e orëve të lira planifikohen hap pas hapi midis mësuesve të lëndës, mësuesve të gjuhës/gjuhëve të huaja, në bashkëpunim edhe me mësues të lëndëve të tjera; gjatë tyre, duhet të organizohen veprimtari që nxisin dhe zhvillojnë motivimin, argëtimin, rritjen intelektuale të nxënësit, frymën e bashkëpunimit përmes punës në grupe/skuadra, etj.

Si veprimtari që mund të zhvillohen gjatë orëve të lira, sugjerojmë organizimin e konkurseve brenda/midis klasës/klasave për tematika të ndryshme; dramatizime pjesësh, recitime tekstesh të përshtashme poetike, interpretim këngësh a lojrash muzikore, etj.

Këto veprimtari duhet të jenë të harmonizuara dhe të shtrira përgjatë vitit shkollor, larg monotonisë, rutinës dhe keqpërdorimit.

V. INTEGRIMI

Programi i gjuhës italiane për klasën e tetë mbështetet në integrimin ndërlëndor, duke e shfrytëzuar atë për aftësimin në rritje të nxënësve në përdorimin e njohurive gjuhësore në përgjithësi dhe të të katër aftësive (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit e të shkruarit).

Konceptet e njohuritë gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore, të cilat lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës italiane dhe të trajtuara në lëndët e tjera.

Trajtimi ndërlëndor i shërben synimeve të përgjithëshme të programit, si dhe realizimit të objektivave të linjave dhe nënlinjave të tij.

VI. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Metodat komunikuese që qëndrojnë në themel të kurrikulës së gjuhëve të huaja, i siguron mësuesit lirinë të përzgjedhë ai vetë materialin dhe ecurinë e orës së mësimit në përshtatje me kushtet e klasës në të cilën punon, mjaft që të përmbushë programin dhe objektivat e parashikuar në respektim të standardeve të arritjes.

Kështu nxënësve u krijohet mundësia të marrin pjesë në veprimtari në të cilat ndërthuren dy apo më shumë aftësi gjuhësore, për të përdorur gjuhën për qëllime reale, për të vënë në zbatim aftësitë e tyre.

Një mundësi me karakter metodologjik lidhet me parimin sipas të cilit nuk mund të realizohet të nxëniti pa pjesëmarrjen aktive të nxënësit. Për të nxitur këtë pjesëmarrje, të përdoren veprimtari në të cilat të ndërfitet sa më shumë të jetë e mundur nxënësi.

Për të ngjallur motivimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve duhen përdorur sa më gjerësisht teknikat e dramatizimit, role-play etj., të cilat bëjnë të mundshme një përfshirje fizike dhe emotive të nxënësit në veprimtari në grup e në çifte dhe i krijon mundësi atij të dalë jashtë mjedisit shkollor, duke shkarkuar tensione, frustrime e duke shmangur filtrin afektiv bllokues, si edhe të nxjerrë në pah personalitetin e vet. Dramatizimi e role-play i krijojnë mundësi pjesëmarrjeje përmes dialogëve në shkëmbime me karakter komunikues, të cilat lypin kryerjen e një roli të caktuar në një mjedis të përcaktuar. Ato bëjnë të mundur përdorimin e disa kanaleve shprehëse për komunikimin: gjuhën, veprimin, gjestin.

Në metodat e reja komunikuese nxënësi gjen vetveten dhe është më i lirshëm për t'u shprehur. Këshillohet puna në grup, mbasi informacioni përgatitet nga të gjithë dhe përgjegjësia për suksesin apo mosesuksesin u takon të gjithëve. Kjo i ndihmon që të ndjehen të bashkuar dhe njësoj të vlerësuar.

Për t'i nxitur nxënësit të shprehen, të komunikojnë duke zhvilluar dhe duke ushtruar aftësitë e tyre potenciale, është e nevojshme kryerja e veprimtarive shprehëse, krijuese, reflektuese, analizuese. Për këtë nevojitet:

Së pari, t'u jepet nxënësve një input më i zgjeruar, nocione dhe njohuri të reja, më të zgjeruara, më të plota e më të thella se ato të ciklit fillor.

Së dyti, të nxiten nxënësit të mbajnë qëndrim për materialin didaktik-edukativ që u jepet. Së treti, të nxiten ata të diskutojnë, të debatojnë (përmes përdorimit të gjuhës italiane). Si garanci për të arritur suksesin në punën tonë si mësues do të shërbejë pjesëmarrja e nxënësve në veprimtari komunikuese, në shkëmbime, të cilat çojnë më pas në rritjen e motivimit dhe në nxitjen e të shprehurit, prej nga kalohet drejt një procesi analize, pjekurie dhe mendimi kritik nga ana e tyre.

Për shpjegimet e ndryshme, si edhe për paraqitjen e veprimtarive praktike, mësuesi të përdorë një gjuhë të qartë e të kuptueshme, një ritëm normal, një shqiptim të dallueshëm e të qartë.

Roli i mësuesit ndryshon. Ai tani luan një rol mbështetës dhe nxitës të veprimtarive individuale dhe autonome të nxënësve. Mësuesi nxit dhe krijon situata mësimore reale.

Gjatë veprimtarive në klasë, mësuesi të përpiqet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundshme gjuhën italishte. Sidoqoftë, për të shmangur raste moskuptimi që nuk do të lejonin zhvillimin e një veprimtarie të caktuar në mënyrën e duhur, të përdoret edhe gjuha amtare.

Pas paraqitjes së veprimtarisë apo të lojës, të fjalëve apo strukturave të reja, mësuesi, të mënjanohet fillimisht nga roli i aktorit e të kalojë në atë të regjisorit që drejton aktorët (nxënësit), duke i nxitur ata e duke dhënë *input*-e apo skena të reja.

Gjuha e përdorur në klasë të jetë e saktë brenda standardit bashkëkohor, në formën, ritmin dhe intonacionin e vet autentik.

Llojshmëria e teknikave didaktike do të bëjë të mundshme që të gjithë nxënësit të përfitojnë duke patur parasysh faktin se aftësitë e tyre nuk janë të njëjta apo të barabarta. Lipset që në punën me grupe apo skuadra mësuesi të përpiqet të sigurojë pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve duke i nxitur të shprehen lirisht.

Reflektimi gjuhësor të jetë:

-Induktiv dhe konkret. Është nxënësi ai që, duke ndjekur mënyrën induktive, zbulon rregullën përmes veprimtarish konkrete gjuhësore.

-I paraqitur në formë veprimtarie apo problemi për zgjidhje, i tillë që ta nxisë nxënësin të vërë në përdorim aftësitë e veta vëzhguese;

-I bazuar jo mbi një metodologji të përqendruar në shpjegimin e rregullës nga mësuesi, por që synon në zbulimin e saj nga vetë nxënësit, natyrisht i ndihmuar edhe nga mësuesi.

Vëzhgimet sistematike të kryera nga ana e mësuesve gjatë procesit mësimor përbëjnë një mjet të favorshëm për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimin, duke u dhënë mundësinë mësuesve që të përfshijnë në kohën dhe vendin e duhur ato përmirësime apo plotësime që ata i gjykojnë të nevojshme. Kur niveli i nxënësve të klasës VIII, për arsye e shkaqe të ndryshme, del më i lartë se ai i përcaktuar në këtë program, atëherë, për të mos shkaktuar de-motivim, si edhe për të shmangur monotoninë, mësuesi mund të propozojë e t'u paraqesë nxënësve të tij materiale të tjera gjuhësore, të zgjedhura e të përgatitura nga vetë ai, duke i integruar me materialin e tekstit të gatshëm, duke ndjekur udhëzimet e mëposhtme:

-të garantojë natyrshmërinë e gjuhës së paraqitur;

-të garantojë përshtatshmërinë e gjuhës me situatën e dialogëve;

-të kufizojë strukturat dhe leksikun e ri të paraqitur;

-të ketë parasysh që gjatësia e tekstit të ofruar të jetë e mjaftueshme për kontekstin e formave të reja që të bëhet kështu i mundur një kuptim dhe një dramatizim i thjeshtë i tekstit;

-të paraqesë një farë shkalle interesi për nxënësit;

-të përdorë mjete vizuale ndihmëse (objekte, pamje, fotografi, revista etj., kur i mungojnë aparatat televizive), të cilat e bëjnë të qartë kontekstin e dialogut dhe e lehtësojnë kuptimin global të materialit të paraqitur;

VII. VLERËSIMI DHE VETËVLERËSIMI

Edhe për klasën e nëntë mund të themi se objektiv i vlerësimit mbetet përparimi i nxënësit realizuar përmes matjes së përparimit dhe të arritjeve në gjuhën italiane. kontrolli shërben e shtrihet gjatë gjithë orës së mësimit dhe është një element i rëndësishëm për të vlerësuar çka është mësuar më parë. Një pedagogjie të diferencuar i korrespondon një vlerësim i diferencuar, që i mundëson secilit nxënës të konstatojë progresin e vet, cilido qoftë niveli i arritur.

Njohja dhe vlerësimi i arritjeve dhe mangësive të nxënësve bëhet duke i dëgjuar ata kur flasin dhe lexojnë ose duke vëzhguar të shkruarit e tyre. Të aftësosh nxënësin që ata t'i përgatitin vetë pyetjet për t'ua drejtuar nxënësve të tjerë, është një ushtrim shumë i mirë për zhvillimin e aftësisë komunikuese.

Vlerësimi formues vë në dukje arritjet e nxënësit në përvetësimin e programit, si dhe ndihmën që jep mësuesi për shmangien e gabimeve.

Vlerësimi përmbledhës bëhet në fund të një numri të caktuar temash, kapitujsh, në fund të semestrit apo të vitit. Ai bëhet në përputhje me objektivat mësimorë. Është e rëndësishme që nxënësi të nxitet drejt vetëvlerësimit, që ai të ndërgjegjësohet për arritjet e punës së vet.

Për të siguruar një vlerësim efektiv të procesit mësimor, të pikënisjes dhe të pikëmbërritjes, të vështirësive të hasura, si edhe të masave të ndërmarra, mësuesit të mbledhin në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme informacion lidhur me zhvillimin dhe asimilimin e njohurive dhe të aftësive, lidhur me gatishmërinë ndaj të nxënës, me shkallën e ndërgjegjësimit për çdo nxënës.

Informacionet të mbledhen në mënyrë sintetike që të bëjnë të mundur një ballafaqim të nivelit të përparimit individual dhe kolektiv, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së marrë në shqyrtim.

SHTOJCË. Këtu më poshtë jepet një shembull modeli praktik, si orientim, se si mund të gërshetohen elementet përbërëse të programit (aftësitë, objektivat/standardet, tematika/ elementet gjuhësore/gramatikore)

TË DËGJUARIT

Përshkrimi i nivelit:	Tema	Akti i komunikimit	Tema dhe funksioni	Gjuha dhe struktura
Nxënësit i shquajnë dhe i kuptojnë çështjet kryesore të një përmbajtjeje të panjohur në tekste më të gjata, që përdorin fjali më komplekse, me ndonjë përsëritje.	Veprimtarite e përditshme. Tema: Ushqimi dhe pija.	Porosisin, blejnë, paguajnë për ushqimin.	Ushqimi, bërja e porosisë dhe e blerjes.	Kuptojnë informacionin kryesor të menysë, vlerësojnë shpenzimet e mundshme.

TË FOLURIT

Përshkrimi i nivelit:	Tema	Akti i komunikimit	Tema dhe funksioni	Gjuha dhe struktura
Nxënësit tregojnë aftësi për t'i përdorur njohuritë e tyre gjuhësore që të zëvendësojnë dhe përshtasin fjalë e fraza në një bashkëbisedim me një gramatikë përgjithësisht të saktë.	Jeta personale e shoqërore. Tema: Unë, familja dhe shokët.	Flasin për planet e afërta, kërkojnë dhe shkëmbejnë mendime për ngjarje të shkuara dhe të ardhshme	Adoleshentët, përgjigja e pyetjeve, përshkrimi i ndjenjave, rrëfimi i ngjarjeve.	Diskutojnë planet për mbrëmjen, paraqesin mundësitë, shprehin mendimet, miratojnë / nuk miratojnë.

TË LEXUARIT

Përshkrimi i nivelit:	Tema	Akti i komunikimit	Tema dhe funksioni	Gjuha dhe struktura
Nxënësit shprehin kuptimin e teksteve të ndryshme që ngër-thejnë fjali të përbëra dhe fjalor të panjohur, ata konsultojnë materiale të panjohura referuese.	Bota e komunikimit dhe teknologjise. Tema :Gazetat, revistat.	Përdorin njohuritë për gjedhet dhe strukturat e gjuhës për të marrë me mend kuptimin dhe për të kapërcyer vështirësitë në rrokjen e teksteve.	Gazetat: Përzgjedhin tekste ose pjesë tekstesh që i përshtaten qëllimit.	Struktura e frazave dhe e fjalive, mbaresat dhe elemente të tjera në strukturën e fjalëve (p.sh. parashitesat).

TË SHKRUARIT

Përshkrimi i nivelit:	Tema	Akti i komunikimit	Tema dhe funksioni	Gjuha dhe struktura
Nxënësit shkruajnë duke përmbushur kërkesat e njohura të lexuesve dhe qëllimet funksionale me një formë përgjithësisht të saktë.	Bota rreth nesh. Tema: Klima dhe moti.	Shkruajnë një rrëfim të shkurtër faktik duke përdorur fjalë të thjeshta lidhëse dhe materiale referuese.	Klima dhe moti. Shkruajnë për lexues dhe qëllime të caktuara me materiale të pa-njohura.	Përgatisin një statistikë që tregon karakteristikat dhe parashikimet e motit në një vend të caktuar.

